


AKC/19



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH**

Gramsh, më 22/05/2018

Nr. 3308/prot
2

Vendim

Nr. 39, dt. 22.05.2018

Për rishqyrtim të vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.33, datë 24.04.2018 “Për familjet që u përmbyten banesat nga krijimi i liqenit HC/Banjë në fshatin Drizë, bashkia Gramsh, si dhe niveli i qirasë mujore që duhet të marrin familjet që strehuan banorët e përmbytur.

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 22/05/2018 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Komisioni ”Për rishqyrtim të vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.33, datë 24.04.2018 “Për familjet që u përmbyten banesat nga krijimi i liqenit HC/Banjë në fshatin Drizë, bashkia Gramsh, si dhe niveli i qirasë mujore që duhet të marrin familjet që strehuan banorët e përmbytur”, të shkresës së Prefektit të Qarkut Elbasan nr.785/1, dt.04.05.2018, ”Kthim akti”, të VKM nr.329, dt. datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.4837/1, datë 05.09.2017 që alokoi fondet “taksën e ndikimit në infrastrukture” në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, ”Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2;

Vendos i:

- I. Të autorizojë Bashkinë Gramsh me cilësinë e palës së tretë (të ndërmjetësit dhe garantuesit) të lidhë kontrata qiramarrje dhe qiradhënie për familjet e përmbytura nga fshati Drizë nga mbushja e HC/Banjë.
- II. Afati i zgjatjes së kontratës, të jetë nga data 01.06.2016 deri në datën e dorëzimit të pallatit të përmbytjes, datë në të cilën lëshohet leja e shfrytëzimit të pallatit.
- III. Tarifa e qiramarrjes të jetë:
 - c) Për familje me përbërje familjare sipas çertifikatës 01.06.2016 deri 5 (pesë) persona tarifa të jetë 20 000 (njëzetë mijë) lekë në muaj
 - d) Për familje me përbërje familjare sipas çertifikatës 01.06.2016 mbi 5 (pesë) persona tarifa të jetë 25 000 (njëzetë e pesë mijë) lekë në muaj
- IV. Numri i kontratave të qiramarrjes e të qiradhënies të jetë 7 (shtatë), si më poshtë:
 - 1. Vesel Çarçiu
 - 2. Xhezmir Çarçiu

- IV. Numri i kontratave të qiramarrjes e të qiradhënieve të jetë 7(shtatë),si më poshtë:
1. Vesel Çarçiu
 2. Xhezmir Çarçiu
 3. Lulëzim Çarçiu
 4. Kujtim Sadiku
 5. Pëllumb Çarçiu
 6. Faik Çarçiu
 7. Ardian Çarçiu
- V. Tatimi 15 % i vlerës së qirasë mujore ndaloheq në burim për qiramarrësin.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë dhe komisionet përkatëse.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.


Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Astrit DUZHA



Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Shkëlqim HOXHA



Konc .Sek.Kësh.A.Duzha



Dosja nr. _____

Afati _____